



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:116605

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06224177

PPP.nr.211/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në çështjen juridike të kreditorit KUR MITROVICA me seli ne Mitrovicë, kundër debitorit E.T, rruga “...” - Mitrovicë lidhur me pagesën e borxhit në shumë ... €, në procedurën e rigjykimit dhe rivendosjes sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AC.nr.8963/21 të datës 03.06.2022, Gjykata më datën 27.09.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET PJESERISHT prapësimi i debitorit E.T nga Mitrovica, ashtu që: **SHFUQIZOHET PJESERISHT** Urdhri mbi lejimin e Përmbarimit P.nr...., te dt.25.09.2020, për periudhën ... e gjere me ... ne shume prej

II. DETYROHET debitori E.T nga Mitrovica që kreditorit KUR MITROVICA me seli ne Mitrovicë, ne emër te borxhit për ujin e harxhuar për periudhën kohore ... e gjere me ..., t’ia paguaj shumen prej ... me kamate ligjore ne lartësi prej 8% nga dita e nxjerrës se këtij aktvendimi e deri ne pagesën definitive te detyrimit, te gjitha këto ne afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes se aktvendimit nën kërcenim të përmbarimit te detyrueshëm.

A r s y e t i m

Kreditori KUR MITROVICA me seli ne Mitrovicë, ka ushtruar propozimin për lejimin e përmbarimit kundër debitorit E.T nga Mitrovica, për pagesën e borxhit ne emër te ujit te shfrytëzuar për periudhën kohore ... e gjere me ... ne shumen prej ... me kamat prej 8% vjetore, si dhe shpenzimet procedurës, te gjitha këto ne afat 7 ditor ne te kundërtën, te bllokohen llogaritë bankare te debitorit, e nëse nuk ka mjete ne llogari te behet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve te luajtshme dhe te paluajtshme e mjetet e mbledhura te derdhen ne llogari te kreditorit, te gjitha këto te specifikuara ne propozimin për përmbarim te dt.

Organi Përmbarues me Urdhrin P.nr...., të dt. ..., e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori E.T nga Mitrovica, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me shkrim, me arsyetimin se urdhri për lejimin e përmbarimit është jo ligjor dhe i pa rregullt sepse nuk i përmban të gjitha kushtet e kërkuara ligjore sipas nenit 38 par.1 të LPP-se, dokumenti në bazë të cilit është lëshuar urdhri përmbarimor nuk ka mundur të ketë cilësinë e titullit përmbarimor dhe të ketë tipare të pëmbareshmërisë, nga ana e kreditorit nuk është bere me kohë regjistrimi dhe dorëzimi i faturave për pagesën e borxhit. Më tutje debitori shtone se kërkesa është parashkruar në tërësi për vitet e mëparshme kalendarike duke u bazuar në nenin 360 par.1 lidhur me par.1.1 të LMD-së, ku janë krijuar kushtet për parashkrimin e borxhit.

Kreditori në afatin e parashikuar ligjor ka bërë përgjigje në prapësimin e debitorit, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta refuzoi si të pa bazuar për faktin se fillimisht kreditori propozimin për përmbarim e ka filluar duke u mbështetur në dokumentin e besueshëm konform nenit 29 të LPP-së, kurse sa i përket parashkrimit këtu kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit konform nenit 368 të LMD-së, pasi që debitori rregullisht i ka pranuar shërbimet e ujësjellësit dhe nuk ka bërë pagesa të borxhit, si dhe nuk kemi pasur ankesa nga debitori se nuk po i shkojnë faturat. Si provë përgjigjes ja bashkëngjisim ekstraktin financiar ku shihet se debitori i ka pranuar faturat dhe lidhur me pagesat e bëra, andaj konsideroi se propozimi i kreditorit duhet të përmbushet konform nenit 27 par.1 dhe 29 par.1.2 të LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin PPP.nr.... të datës ... e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit si të bazuar duke e shfuqizuar pjesërisht urdhrin përmbarimor ashtu që shumë prej ... euro e ka zbritur në shumë prej ... euro për shkak se një pjesë e borxhit është parashkruar.

Kreditori, i pa kënaqur me vendimin e lartcekur ka ushtruar ankesë me datë 04.02.2021, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e parashtruar, të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë apo të ndryshohet aktvendimi dhe të aprovohet prapësimi në tërësi.

Gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin Ac.nr.... të datës ... e ka aprovuar ankesën e kreditorit, ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje me vërejtjet dhe rekomandimet që të vlerësohen në mënyrë të drejtë pretendimet nga ankesa dhe të vlerësojnë në mënyrë të drejtë faktet vendimtare, për shkak se aktvendimi i atakuar është perfshire në vërtetim të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-se si dhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale respektivisht neni 360, par.1, pika 1.1 lidhur me nenin 368.1 të LMD-se.

Gjykata Themelore Mitrovicë, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP-së, dhe konform vërejtjeve dhe sugjerimeve të gjykatës së shkallës së dytë vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se e njëjta është pjesërisht e bazuar. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohet përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresa të lëndës si dhe lidhur me pretendimet e debitorit kur thirret në atë se urdhri për lejimin e përmbarimit është jo ligjor dhe i pa rregullt sepse nuk i përmban të gjitha kushtet e kërkuara ligjore sipas nenit 38 par.1 të LPP-së, dokumenti në bazë të të cilit është lëshuar urdhri përmbarimor nuk ka mundur të ketë cilësinë e titullit përmbarimor dhe këtë tipare të përmbarueshmërisë, nga ana e kreditorit nuk është bërë me kohë regjistrimi dhe dorëzimi i faturave për pagesën e borxhit, pretendimet e larte cekura gjykata i refuzoj si të pabazuara, për faktin se kreditori propozimin përmbarim e ka iniciuar në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afarist, sipas nenit 29 par. 1.2. në lidhje me par.3 të LPP-së, i njëjti konsiderohet dokument i besueshëm dhe është i përshtatshëm përmbarim, po ashtu në shkresat e lendes gjendet kartela financiare e konsumatorit dhe që nga viti ..., e deri në momentin e paraqitjes së propozimit për përmbarim janë të specifikuar si data numri, vendi sasia e ujit të harxhuar, vlera në euro, pagesat eventuale si dhe borxhi i përgjithshëm.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret në atë se kërkesa është parashkruar në tërësi për vitet e mëparshme kalendarike duke u bazuar në nenin 360 par.1 e lidhur me par.1 .1 të LMD-së, ku janë krijuar kushtet për parashkrimin e borxhit, gjykata gjeti se të njëjtat pretendime janë pjesërisht të bazuara, për faktin se i tërë borxhi me të cilin ngarkohet debitori E.T, nga Mitrovica, për periudhën kohore ... e gjere me ..., është borxh i parashkruar, konform nenit 360 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, për faktin se edhe pse debitori nga transaksioni i kreditorit gjatë kësaj periudhe shihet se ka bërë disa pagesa paushallë, mirëpo kreditorit gjatë kësaj periudhe shihet se ka bërë disa pagesa paushallë, mirëpo nuk ka dëshmi se këto pagesa janë bërë në emër të borxhit paraprak apo në emër të faturave për muajt vijues, dhe se me vet faktin se ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk ka ekzistuar paraprakisht një marrëveshje për ri programimin eventual të borxhit këto pagesa nuk e ka bërë ndërprerjen e rrjedhës së afatit të parashkrimit, konform nenit 368 të LMD-së. Njëkohësisht, ky është edhe qëndrim i Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar vendimin të saj (aktgjykimi Rev. nr.148/12 dt.09.09.2013).

Kurse sa i përket borxhit për periudhën kohore ... e gjere me ..., gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit, në raport me debitorin për këtë periudhe kohore, referuar nenit 360 par.2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligjit nr. 04/L-077), parashihet që afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti, fillon të rrjedhë në fundin e atij viti, e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura në vitin ..., afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë me ... dhe në rastin konkret nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka parashtruar me dt...., me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhës së afatit të parashkrimit, konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligjit nr. 04/L-077).

Sa i përket Kamatës së aplikuar për detyrimin e aprovuar si në pikën II të dispozitivit, gjykata u referua nenit 382, par1 dhe 2 të LMD-se.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, dhe konform dispozitave të nenit 3, 13 par.4, 17,37,69,71 e73 par. 3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, si dhe lidhur me nenin 245 par.1 249 par.1 dhe 305 par.1 dhe 2 të LMD-se, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.,

Numri i lëndës: 2021:116605
Datë: 27.09.2024
Numri i dokumentit: 06224177

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
PPP.nr.211/2022, datë 27.09.2024

GJYQTARI

Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa parashtrohet përmes kësaj gjykate.